



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 141 Dt. 30/12/20



ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.1, 1.3 dhe 1.17 të Ligjit nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësorë, nenit 20, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1. dhe 1.3 të Statutit të OFTK-së, në mbledhjen e mbajtur me 26/12/2020 , nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet plani i punës i Odës së Farmacistëve të Kosovës për vitin 2021
- II. Planin e punës i bashkangjitet këtij vendimi
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i OFK-së

Kryetari i OFK-së

Dr.sc. Arianit Jakupi





**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 141 Dt. 30/12/20

PROGRAMI I PUNËS

AKTIVITET E ODËS SË FARMACISTËVE 2021

Prishtinë, Dhjetor 2020



Programi i punës për vitin 2021	3
1. Vazhdimi i procesit të anëtarësimit, licencimit dhe rilicencimit	4
2. Kalimi nga shërbimet fizike në shërbime online të OFK-së	4
3. Plotësim ndryshimi i Legjislacionit të OFK-së	5
5. Fushata vetëdijësuese për Kodin Etik dhe rolin etik	6
6. Auditimi financiar për vitin 2019 dhe 2020	6
7. Revista farmaceutike profesionale – shkencore.....	6
8. Përkrahja e farmacistëve për punime shkencore	6
9. Organizimi i aktiviteteve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional	7

Programi i punës për vitin 2021

Të nderuar kolegë farmacistë,

Programi i punës për vitin 2021 është program i cili është bazuar në programin e përgjithshëm të OFK-së që del nga kompetencat dhe përgjegjësitë e Odave të Profesionistëve Shëndetësore – OPSH, por gjithashtu edhe gjendjes së pandemisë në të cilën ndodhemi që ka shkaktuar jo vetëm vështirësi shëndetësore për të gjithë ne, por në aspektin profesional për farmacistët gjithashtu edhe vështirësi organizative apo edhe vështirësi në zhvillimin e përgjegjësive ditore të ushtrimit të profesionit.

Sidoqoftë Oda e Farmacistëve të Kosovës duke u angazhuar maksimalisht që të plotësojë të gjitha obligimet e saj në raport me anëtarët – farmacistët është munduar që të bëjë një plan të punës i cili do të mund ti përgjigjet edhe kërkesave por edhe ti kontribuojë zhvillimit në përgjithësi.

Në këtë plan të punës jemi munduar që të përfshijë jo vetëm aktivitetet e parapara lidhur me anëtarësimin, licencimin dhe rilicencimin e farmacistëve por edhe fuqizimin e proceseve që kanë të bëjnë me edukimin e vazhdueshëm profesional. Gjithashtu një pikë shuë e rëndësishme është procesi i kalimit të shërbimeve elektronike për anëtarët apo platforma elektronike e cila do të mundësojë kryesrjen e shërbimeve pa qenë nevoja për prezencë fizike në OFK dhe kjo në formë të “one stop shop” në mënyrë që të lehtësohet sa më shumë ky proces. Plani i punës përmban edhe shumë pika të tjera të cilat do ti paraqesim një nga një në vijim me sqarimet përkatëse.

Këshilli drejtues i OFK në mbledhjen e mbajtur më datë xxxxxxxx, pa të gjitha procedurave, shqyrtimit të detajuar dhe diskutimeve në këshill mori vendim për të aprovuar këtë program të punës dhe ta dërgojë atë te anëtarët e kuvendit të OFK-së si organi më i lartë vendimmarrës për aprovim.

Kuvendi i OFK në mbledhjen e mbajtur më 26.12.2020 aprovoi programin e punës për vitin 2021 duke obliguar këshillin drejtues dhe strukturat tjera organizative për të zbatuar atë.

Në vijim po e paraqesim planin e punës në pika dhe sqarime lidhur me secilin proces.

1. Vazhdimi i procesit të anëtarësimit, licencimit dhe rilicencimit

Duke u bazuar në të dhënat e databazës së anëtarësisë të OFK-së, planifikohet që në vitin pasues të kryejnë obligimin e anëtarësimit rreth 1270 anëtarë aktual të OFK-së.

Po ashtu duke u bazuar në këto të dhëna, në vitin 2021 procesit të rilicencimit do t'i nënshtrohen të paktën 70 farmacistë të cilëve afati i validitetit të licencave të tyre ju skadon këtë vit. Nga praktika e viteve paraprake presim që për herë të parë të licencohen rreth 100 farmacistë.


2. Kalimi nga shërbimet fizike në shërbime online të OFK-së

OFK tashmë është në fazën e testimit të platformës online për shërbimet online ndaj anëtarëve të saj. Me funksionalimin e kësaj platforme shërbimet e OFK-së do të jenë shumë më efikase dhe të shpejta.

Platforma fillimisht do të ofrojë shërbimet për sa i përket anëtarësimit, licencimit, rilicencimit dhe edukimit të vazhdueshëm profesional duke lehtësuar punën e farmacistëve në raport me shërbimet e OFK-së.

Platforma mundëson që të gjitha kërkesat si për anëtarëim, kërkesat për licencë dhe rilicencim, tërheqja e faturave për shërbimet, valorizimi, akreditimi i aktiviteteve të EVP-së të ofrohen online pa qenë nevoja për prezencë fizike në zyrat e OFK-së.

Platforma në periudhën Mars-Qershor 2021 do të përsoset edhe më tutje duke shtuar edhe komponentën e platformës së mbikëqyrjes etike dhe besojme edhe duke shmangur lëshimet teknike që mund të dalin gjatë kësaj faze të testimit të saj.





3. Plotësim ndryshimi i Legjislacionit të OFK-së

Tashmë është në diskutim publik Projektligji për Shëndetësi. Si tillë ky projektligj parasheh detyrimin që brenda periudhës 1 vjeçare nga hyrja në fuqi të krijohet legjislacioni adekuat për implementimin e detyrimeve të parapara në projektligj.

Veçmas kërkohen ndryshime në Statutin e OFK-së në implementim të bartjes së teknikëve të Farmacisë si pjesë e Odës së Farmacistëve të Kosovës dhe ndryshimet tjera të akteve ligjore për sa i përket realizimit të komencës së paraparë në lidhje me praktikë profesionale të profesionistëve shëndetësor të hartoj dhe mbikëqyrë zbatimin e plan programit dhe verifikon aftësitë e fituara gjatë praktikës profesionale.

Gjithashtu janë të parapara ndryshime edhe në Ligje tjera si Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Ligji për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, Ligji për Inspektoratin dhe rrjedhimisht edhe për udhëzimet përkatëse administrative për të cilat OFK do të japë kontributin e saj në delegimin e anëtarëve kompetent në këto grupe punuese. Konsiderojmë se kjo është një çështje shumë e rëndësishme andaj edhe do të bëjmë përpjekje maksimale që të shqyrtojmë me shumë kujdes secilën çështje të kësaj natyre.

Po ashtu në zbatim të rekomandimeve të komisioneve përkatës për plotësim ndryshim të rregulloreve të komisioneve për të cilat ka pasur pengesë në zbatim praktikë të tyre do të rekomandohen edhe plotësim ndryshimi i akteve tjera të brendshme të OFK-së.

4. Hapësira e përkohëshme për ushtrimin e veprimtarisë së OFK-së

Ndryshimi i hapësirave të zyrës së OFK-së deri në ndërtimin e objektit të përbashkët të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë.

Kjo çështje mbetet si një nga opsionet pasi që OPSH janë përfituese të një doancioni nga qeveria e Luxemburgut për ndërtimin e objektit të përbashkët të OPSH, Oështje e cila ka mbetur në pritje të vendimit për ndarjen e parcellës pas kërkesës që OPSH i kanë bërë bordit të SHSKUK pasi kemi konsideruar se objekti më së miri do të ishte që të ndërtohej në kuadër të kompleksit spitalor universitar. Por deri atëherë shpresojmë që të na shërbejë një hapësirë (2 zyra) e përkoshme në kuder të kompleksit të QKUK.

5. Fushata vetëdijësuese për Kodin Etik dhe rolin etik

Me funksionalizimin e Komisionit për Etik të OFK-së, bashkarisht me Këshillin Etik do të organizohen fushatë promovuese mbi normat e sjelljes, njohjen me kodin etike dhe rëndësinë e farmacistit në sistem shëndetësor.

Ndër të tjera do të organizohen fushata informuese në lidhje me shkeljet etike dhe masat disiplinore për këto shkelje.

6. Auditimi financiar për vitin 2019 dhe 2020

OFK do të vazhdojë që përveç raportimit të detyrueshëm vjetor në Ministrinë e Shëndetësisë të bëjë edhe auditimin e pavarur të pasqyrave financiare në mënyrë që kjo ti shërbejë transparencës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të gjendjes së përgjithshme në OFK.

7. Revista farmaceutike profesionale – shkencore

Këshilli Drejtues i OFK-së tashmë ka miratuar Këshillat përkatëse të Revistës profesionale - shkencore, pas së cilës në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 planifikohet botimi i numrit të parë të revistës profesionale – shkencore. Kjo revistë planifikojmë që të botohet dy herë në vit dhe mund të ketë sipas nevojës edhe suplemente shtesë. Revista do të ketë karakter informativ, debatues, shqyrtimit të politikave shëndetësore, hulumtimeve shkencore etj.

8. Përkrahja e farmacistëve për punime shkencore

Ndarja e granteve të parapara për përkrahje shkencorë të punimeve të anëtarëve të OFK-së në përputhje me vijën buxhetore të ndarë nga Kuvendi i OFK-së. Kuvendi i OFK dyfishoi buxhetin e paraparë për përkrahje financiare të anëtarëve për vitin 2021.

Konsiderojmë që kjo ti shërbejë sado pak nxitjes së projekteve apo hulumtimeve profesionale dhe shkencore të anëtarëve dhe të krijojmë një traditë që në të ardhmen të mund edhe të kemi një buxhet shumë më të lartë që do të ishte domethënës për hulumtuesit në farmaci.



9. Organizimi i aktiviteteve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Farmacistëve të Kosovës me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të anëtarëve të sajë dhe të mundësisht të përmbushjes së kriteve ligjore për rilicencim të anëtarëve do të organizojë dy aktivitete të EVP-së. Një në gjashtë mujorin e parë dhe një në gjashtë mujorin e dytë. Forma e organizimit të aktiviteteve (online apo me prezencë fizike) do të përcaktohet varësisht nga masat parandaluese me COVID 19 të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës.

Me poshtë po ashtu po paraqesim edhe disa nga aktivitetet të cilat OFK do t'i shënojë qoftë me (shkrim, tryezë, konferencë, ngjarje e veçantë, etj.)

- Dita botërore e kancerit – 4 Shkurt 2021
- Dita botërore e turberkulozit – 24 Mars 2021
- Dita botërore e shëndetit – 7 Prill
- Dita kundër konsumimit të duhanit – 31 Maj 2021
- Ditës botërore të farmacistit – 25 Shtatori 2021
- Dita e sëmundjeve të zemrës – 26 Shtator 2021
- Muaji i vetëdijësimit për kancerin e gjirit – 1-31 Tetor 2021
- Dita e shëndetit mendor – 10 Tetor 2021
- Dita botërore e diabetit – 14 Nëntor 2021
- Java e vetëdijësimit të përdorimit racional të antibiotikëve – 18-24 Nëntor 2021
- HIV/AIDS – 1 Dhjetor 2021



Kryetari i OFK-së

Dr. Sc. Arianit Jakupi